

- 2 Infermeria – Shëdneti** **3 Ashpërsimi i pabarazisë** **4 Seminari i Unia në shqip**
Pikëpamja e personit në qendër të vëmednjës **Barazia përmes taksimit të 1% të pasanikëve** **me 11 e 12 mars 2023 në Vitznau LU**

Nr. 1 | Shkurt 2023 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

14 qershori, dita e grevës së grave po afrohet

Barazia nga perspektiva sindikaliste



Pamje nga greva madhështore e grave me pjesëmarrje ndër më masivet në historinë e lëvizjes së grave

Përse nevojitet «përsëri» një grevë gjithë-zvicerane? Në këtë pyetje gratë japin këtë përgjigje: «Barazia nuk është arritur ende, andaj nevojitet greva e grave, presion të grave në ndërmarrje, në rrugë, në shtëpi dhe gjithandej.»

Emine Sariaslan

Në vitin 1991 gratë kërjuan paga të barabarta, dhënie fund ngacmimit seksual, barazi tek çështjet e sigurisë sociale. Greva e grave është suksesi i madh mobilizues në historinë e Zvicrës – edhe para grevës kombëtare. Disa qindra mijëra gra morën pjesë. Ndër të tjera gratë bëjnë grevë, sepse edhe pse ato kryejnë shumë punë, jo gjithmonë paguhen për punët që bëjnë. Veprimtaria e tyre nuk perceptohet si punë, pasi që disa nga punët që ato bëjnë nuk trajtohen si punë prodhuese, andaj dhe për to nuk merret pagë.

Greva e grave 2023

Gratë e Unia, ato të Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës (BSZ), organizatat e grave, komitetet e grave, shoqatat e migranteve po përgatiten për grevën e grave të 14 qershorit: «Fjala është për një grevë që përfshin edhe ndërprerjen

e punës» thanë gratë në Kongresin e grave të BSZ-së. Gratë kanë edhe më tej 20% pagë më pak. Moshja e pensionimit për gratë është ngritur, edhe pse gjatë votimeve për këtë ndryshim të ligjit të pensioneve shumica e grave kanë votuar kundër. Edhe e drejta e ndërprerjes së shtatzënisë përmes dy nismave parlamentare është duke u vu në pikëpyetje. Gratë nuk duan të pranojnë as pabarazinë në paga e as përqesimin e kushteve të jetesës. Gratë sindikaliste gjithashtu edhe më tej duan një reduktim të caktuar të vëllimit të punëve pa gjobitje në pagë, në mënyrë që gratë dhe burrat të ndajnë në mënyrë të barabartë punët e paguara e ato pa pagesë dhe që pagat e grave të përmirësohen. Pos kësaj duhet të ketë edhe pushim të tillë për prindër, që u përgjigjet prindërve. Paga dhe kushte më të mira pune, pensione më të larta, vlerësim të profesioneve me pjesëmarrje të lartë të grave. Me një

mbrojtje të njëmendë ndaj diskriminimit dhe ndaj çdo forme të dhunës seksuale, dhe një përkujdesje të fëmijëve si shërbim publik, nevojitet si nxitje për ndryshim drejt barazisë së njëmendë.

Migrantët janë aktiv kundër diskriminimit të shumëfishtë

Me 14 qershor migrantët do të bëjnë grevë kundër diskriminimit të shumëfishtë, duke dalë në rrugë. Një person, që është femër dhe e zezë, apo femër dhe migrante, përballet me diskriminim të dyfishtë apo shumëfishtë. Ato kërkesat e tyre do ti bartin nëpër ndërmarrje, si dhe në rrugë: Njohja e pranimi i diplomave të tyre, e drejta në natyralizim, siguria e qëndrimit dhe shumëçka tjetër.

Barazia nga perspektiva sindikaliste

Për ne, barazia domethënë më shumë

se sa vetëm një grua e zgjedhur në parlament, apo dhe vetëm për të pasur më shumë gra si kuadro udhëheqëse në një kompani. Gjatë votimit për AHV/AVS-21 ne kemi parë, që gratë borgjeze nuk janë treguar solidare me gratë që ushtrojnë profesione të rënda, kanë paga të ulëta dhe punojnë në kushte të pasigurta. Ne duam barazi. Jeta jonë duhet të jetë më e vlerësuar se profiti! Ne kërkojmë një reduktim të kohës së punës dhe paga për të jetuar më mirë. Sot pagat tona, shkaku i inflacionit, janë nën presion. Kushtet tona të punës përqesohen prorre. Ky realitet prekë të gjitha punëtorët. Mirëpo për shumicën prej nesh situata sa vjen e është duke u përqesuar, pasi pagat tona janë të ulëta, vëllimi i punës me pagesë i vogël dhe pensionet tona të ulëta e veçanërisht që shumicën e punëve pa pagesë edhe më tej i marrim ne përsipër.

Editorial



Greva e grave 2023 ka filluar

Viti 2023 do të jetë një vit luftarak, pasi me 14 qershor është greva e grave. Tek barazia ne në vend të përparimit aktualisht kemi kthim mbropa; tek pagat, tek pensionet dhe tek ndarja e punëve të përkujdesjes. Prandaj, ne duhet të luftojmë deri në arritjen e barazisë. Presioni nga rruga dhe nëpër ndërmarrje do të ketë rëndësi të jashtëzakonshme: Për këtë arsye parulla luftarake e grevës së grave 2023 është: **Respekt, më shumë pagë, më shumë kohë.**

Nga përlogaritja gjatë jetës së punës, del se të ardhurat e grave janë ende 43.2 për qind më të ulëta se të burrave. Hendeku i pagave që nga viti 2016 është zgjeruar përsëri, dhe pagat reale në sektorët me paga të ulëta kanë rënë. Në këto sektorë punojnë shumica e grave. Dhe sa i përket shpërndarjes së punës së paguar dhe të papaguar, ne e kemi pa qartë gjatë pandemisë së koronës, se para së gjithash gratë kanë marrë përsipër shkollimin në shtëpi dhe kujdesin për fëmijët. E llogaritur në franga zvicerane, vlera e punës së papaguar, që është kryer kryesisht nga gratë, është 315 miliardë franga zvicerane.

Një shoqëri më e drejtë dhe më sociale është një zotim i përhershëm sindikal dhe na përket të gjithëve. Ne mbështesim lëvizjet feministe. Si sindikatë ne duam të përqëndrohemi kryesisht tek ndërmarrjet, në të cilat punojnë shumë gra. Në degët, të cilat gjatë koronës janë duartrokatur si «relevante për sistemin», e ku tek pagat dhe kushtet e punës megjithatë asgjë nuk është përmirësuar. Ne do tu dalim në krah të gjitha grave, të cilat janë të gatshme të ndërpresin punën në ndërmarrjet e tyre: Angazhohu edhe ti, sepse vetëm së bashku ne jemi më të fortë!

Vania Alleva, kryetare e Unia

Prandaj ne do të bëjmë grevë me 14 qershor, duke dalë në rrugë! Bashkohu edhe ti!

News

Sulme të padinjitetshme mbi pagat minimale kantonale

Parlamenti ka aprovuar një mocion të rretheve të afërta të punëdhënësve dhe donë ti zbrisë pagat minimale kantonale. Me këtë pagat minimale në kantonet e Gjenevë dhe Neunburgut mund të zbrisin dhe kështu shumë njerëz do të varfërohen. Të prekura do të ishin parasëgjithash gratë. Unia do ti luftojë këto përpjekje të padinjitetshme, për të zbritur pagat nën minimumin e ekzistencës. Topi tani është tek Qeveria federale, e cila deri më tani ka refuzuar mocionin përkatës të Ettlinit. Unia pret me padurim parashtresën e Qeverisë federale dhe bashkë me anëtarë edhe më tej do të angazhohet për paga, të cilat mundësojnë një jetë më dinjitet.

Risi: Liria e lëvizëse midis tre sistemeve të daljes në pension të parakohshëm për degët anësore të ndërtimitarisë

Lajme të mira për punëmarrësit e Zvicrës perëndimore të zejeve përmblylëse, të degës së ljerje-suvatimit të Zvicrës gjermane dhe të degës së mbështjelljes së ndërtesave: Rishitas sistemet e pensionimit të parakohshëm marrin parasysh të gjitha vitet kontribuuese tek përllogaritja e pensionit. Nga ky përditësim përfitojnë të gjithë ata, që për shkak të ndërrimit të punëdhënësit apo ndërrimit të kantonit kanë humbur këtë të drejtë. Në të ardhmen bëhet i mundur ndryshimi mes tri sistemeve të pensionimit të parakohshëm në zejet anësore të ndërtimitarisë (gjegjësisht të zejeve përmblylëse). Kjo domethënë se me rastin e ndërrimit të punëdhënësit do të merren parasysh të gjitha vitet e kontributeve në të gjitha institucionet e pensionimit të parakohshëm.

Ndhmësit bashkëpunues liberal të Uber

Edhe përkundra modelit ilegal të biznesit, Uber arriti të përbirohet në Zvicër. Tani dokumentet flasin: Korporata e SHBA rrugë diskrete ka kërkuar ndihmë me ndikim. Dhe ata i gjeti parasëgjithash tek Partia Liberale e Zvicrës (FDP/PLR). Dokumentet vijnë nga ish shefi i lobuesit i Uber për Evropë, Mark MacGann. Pas tërheqjes së tij ai u bë zbuluesi kryesor i parregullsisë: Në intervistë me «Sonntagszeitung» tani ai kritikon këtë praktikë si armike të demokracisë: Ne kemi thënë: Këto ligje nuk përkohjnë me modelin tonë të biznesit. Ne tani thjeshti i injorojmë ato. Motoja jonë ishte: Është më me profit, të kërkojmë falje më vonë, se sa të pyesim paraprakisht, se a lejohet. «Kur kjo në fund mendohet, secila ndërmarrje e pasur mund të thotë: Unë nuk pajtohem me demokracinë e juaj, pra unë mund të bëjë çka të dua». Deri më tani Uber refuzon gjithandëj, për të paguar kontributet e shoferëve në sigurimet shoqërore, duke ua bartur në kurriz vet shoferëve.

Aktuale për SansPapiers (personat pa letra)



Në dhjetorin e vitit të kaluar senati zviceran u shpreh për zgjerimin e qasjes së rasteve të vështira në arsimimin profesional për njerëzit pa letra (SansPapiers). Kështu dhoma e vogël e parlamentit (senati) vërtetoi vendimin e dhomës së madhe (parlamentit nacional). Për platformën SansPapiers të Zvicrës ky është një hap historik, për faktin se senati donë të përshtatë rregullat, që nuk janë praktikuar deri më tani. Në lidhje me shëndetin, mirëqenies dhe kushteve të punës të SansPapiers me 15 shkurt 2023 në Gjenevë do të mbahet një simpozium, ku do të prezantohen rezultatet e hulumtimit të gjatë ndërdisiplinor (2027–2023). Rezultate këto që do të prezantohen në vazhdim të Operacionit «Papyrus».

KKP Personeli i huazuar

Shtrirje e re dhe paga minimale më të mira

Në vitin e ri rriten pagat minimale në Kontratën Kolektive të Punës (KKP) për personelin e huazuar. Përveç kësaj, ato tani zbatohen për të gjithë sektorët me personel të huazuar. Kjo shtrirje ka vlefshmëri të përgjithshme.

Darinka Filipovic

KKP për personelin e huazuar ka një sistem të përshkallëzuar të pagave minimale. Secili që huazohet në një sektor, në të cilin vlen një Kontratë Kolektive Pune me vlefshmëri të përgjithshme, ka të drejtë në pagën minimale të përcaktuar në të. Pagat minimale të Kontratave Kolektive të Punës pa vlefshmëri të përgjithshme megjithatë do të vlejnin, nëse KKP përkatëse është e evidentuar në shtojcën 1 të KKP për personelin e huazuar.

Të 11 KKP-të e integruara

Pra kjo liste, nga 1 janari 2023, do të zgjerohet me 11 kontrata të rëndësishme: Rishitas ndër të tjera do të jenë KKP e Industrisë së makinerisë, elektricitetit dhe metalit (KKP MEM); KKP-ja e ndërmarrjeve gjermanofolesë të orëve dhe mikroteknikës si dhe katër KKP-të e sektorit social dhe të shëndetësisë janë të evidentuara në listë. Qeveria Federale këtë zgjerim e ka shpallur me vlefshmëri të përgjithshme.

S'ka më përjashtime

Kështu në këta sektorë për punëtorët e përkohshëm vlejnin të njëjtat rregulla përkittazi me orarin e punës dhe pagat minimale sikur për të punësuarit e përhershëm.

Kushdo që në një ndërmarrje të veçantë pa KKP huazohet, do të merr pagën minimale të KKP për personelin e huazuar. Të gjitha përjashtimet e këtij rregullimi – sikur deri më tani para së gjithash në industri – do të mënjanojnë.



Zhgjërimit i vlefshmërisë dhe përmirësime të dukshme me KKP për personelin e huazuar

Pagat e reja minimale

Nga 1 janari 2023 (gjegjësisht nga 1 dhjetor 2022 për Tiçino) vlejnin këto paga minimale:

Pagat bazike/ora*	pagat normale**	Pagat e larta**	Tiçino
Të kualifikuar	CHF 24.25	CHF 25.90	CHF 22.55
Gjysmë të kualifikuar	CHF 21.34	CHF 22.79	CHF 19.85
Të pakualifikuar	CHF 19.92	CHF 21.02	CHF 18.00

* Përfshirë pagën e 13 mujore, pushimet e festat sipas KKP e personelit të huazuar

**Si regjione me paga të larta vlejnin zona e Bernës, ajo e Arc Lémanique si dhe Kantonet e Bazelit (qytet), Gjenevës, Bazel (vend) dhe Curyh. Në Gjenevë vlen paga minimale kantonale, në rast se është më e lartë.

Infermiera – shëndeti

Hulumtimi që e vendos pikëpamjen e personelit të në qendër të vëmendjes

Sistemi shëndetësor është në krizë – dhe së fundi jo vetëm shkak ngarkesave të pandemisë së Covid. Qysh me 2018/19 një anketë e Unia gjeti, që 89% e infermierëve duhet të punojnë prora të shtresuar dhe nën presion kohor në shtëpitë e kujdesit, 72% kanë qenë të pakënaqur me planin e shërbimit dhe 80% nuk e kanë konsideruar korrekte pagën e tyre. Është tronditës fakti që një 87% e tyre kanë deklaruar se nuk kanë kohë të mjaftueshme për ti përkujdes banorët e shtëpive të pleqve.

Hilmi Gashi

Që nga pandemia për çdo muaj nga profesioni i tyre largohen mbi 300 infermierë. Në njërin anë arsye për këtë, pos kushtet e këqija të punës, janë: Plani i turneve pamundëson një jetë të shëndetshme familjare, presioni ndikon që shumë infermiere duhet të punojnë me orar të përkohshëm për të mos u sëmure, prandaj për këtë arsye pagat janë më të ulëta. Në anën tjetër shumë infermierë raportojnë për konflikt ndërgjegjeje: ata nuk mund të kujdesen ashtu si kanë mësuar dhe si do ta bënin me kënaqësi, pasi që për këtë koha nuk është e mjaftueshme dhe nga punëdhënësi janë të detyruar të jenë më shumë efikas. Efikasiteti: ishte edhe synimi i Parlamentit dhe Qeverisë federale, kur është aprovuar financimi i infermierisë. Infermierja, në kuptimin e prodhimitarisë së linjës montuese, për shumë infermiere nuk është zgjidhje – ata më me dëshirë do e lëshonin profesionin.

Ndërkohë që e dimë: banoret e banorët e shtëpitë të kujdesit kanë merituar një infermieri të mirë – ky është një detyrim i yni njerëzor. Mirëpo, çka është infermiera e mirë, shpesh e vendosin politika dhe punëdhënësit. Këtë ne duam ta ndryshojmë – pasi

infermierët e dinë më së miri, se çfarë përkujdes nevojitet. E përkrahur dhe e cytur nga Unia, Shkolla e lartë profesionale e Zvicrës jugore (SUPSI) është duke e realizuar një hulumtim studimor, për tu mundësuar infermierëve që të shprehen. Në të gjitha pjesët e Zvicrës do të zhvillohen intervista grupore, në të cilat të prekurit do të shprehen dhe të japin mendimin e tyre mbi «infermieri e mirë». Që kjo të dëgjohet një herë e mirë.

Përmes rezultateve të projektit hulumtues, Unia bashkë me anëtarët e saj dhe organizatat tjera do të përpunojë një manifest, i cili do të përmbajë kërkesat tona për infermieri të mirë. Pasi: infermiera e mirë ka nevojë për kushte të mira pune.

Për intervistat grupore neve na nevojiten të punësuar, të cilët marrin pjesë në anketë dhe që duan ti paraqesin perspektivat e tyre. Qoftë si specialist i kualifikuar i infermierisë, asistent i infermierisë, apo i hotelierisë. A punon ti në një shtëpi përkujdes të pleqve? Atëherë bëhu pjesë dhe plotësojë anketën tonë të vogël online për tu regjistruar. Nën lidhjen vijuese ti gjen të gjitha informacionet.

Italisht:



Frëngjisht:



Gjermanisht:





Ashpërsimi i pabarazisë

Taksimi i të pasurve: një zgjidhje konkrete për pabarazinë në rritje

Ashtu si del nga raporti vjetor i Oxfam, i cili u publikua me rastin e forumit të Davosit, në dy vitet e fundit 1% e më të pasurve kanë përvetësuar gati 2/3 e gjithë pasurisë botërore. Taksimi i të pasurve nuk është më vetëm një zgjidhje, por një nevojë absolute.

Marie Saulnier Bloch

Prapambetja dhe zgjerimi i pabarazive

Në vitin 2022 banka botërore bëri të njohur, se synimi, që deri në vitin 2030 të mënjanohej varfëria ekstreme, nuk mund të arrihet dhe se «përparimet për zvogëlimin e varfërisë ekstreme ka vendnumëruar». Sipas FMN-së, 1/3 e ekonomisë globale do të jetë në recesion deri në vitin 2023. Sipas Oxfam, të paktën 1.7 miliardë njerëz në gjithë botën kanë paga që nuk po arrijnë të mbajnë hapin me inflacionin, që do të thotë një rënie reale e aftësisë së tyre për të paguar faturat. Edhe shtetet po përballen me falimentimin pasi shlyerja e borxhit po del jashtë kontrollit.

«Çdo miliardar mban përgjegjësi për dështim të politikës publike»

Në të njëjtën kohë, sipas analizës së kryer duke përdorur të dhënat e Crédit Suisse, përvetësimi i pasurisë nga të pasurit e mëdhenj është përshtetur që nga viti 2020. 1% e më të pasurve kanë përvetësuar pothuajse 2/3 e të gjithë pasurisë së re, gjashtë herë më shumë se 90% e më të varfërve të njerëzimit. Që nga viti 2020, krahasuar me çdo dollar që fiton një person i 90% të më të varfërve të popullsisë së botës, një miliardar fitoi 1.7 milionë dollarë.

Masa të qarta për një botë me të barabartë

Është koha që të fuqizohet kapaciteti i autoriteteve tatimore, posaçërisht për të gjurmuar fshehjen e pasurisë në parajsat tatimore.

Konkretisht raporti kërkon vullnet politik, i cili mundëson taksa të reja solidariteti mbi pasurinë, fitimet e korporatave dhe pagesat e dividendëve, për ti dhënë fund përfitimeve që dalin nga kriza. Tatimi mbi të ardhurat (puna dhe kapitali) të 1% e më të pasurve duhet të rritet në mënyrë afatgjatë, p.sh. në një normë minimale prej 60%. Edhe dy vite pas dështimit të nismës 99%, debati nuk ka përfunduar ende...

Edhe në temën e dhurimit të organeve të rinjtë identifikuan nevojën për veprim dhe i dhanë përparësi nevojave për informacion të popullatës. Në një peticion tjetër sesioni i të rinjve 2022 kërkoi mënjanimin e subvencioneve të dëmshme për biodiversitetin të Zvicrës. Këto janë disa nga kërkesat, të cilat u vendosën nga plenumi dhe që në orët e fundit të sesionit të dielën iu dorëzuan presidentes së Parlamentit nacional Irène Kälin.

Ata munden dhe duan

Të 200 të rinjtë me kërkesat e tyre bënë të qartë, që e kuptojnë aktivitetin politik, që mund të informohen dhe debatohen dhe që marrin përsipër përgjegjësi për shoqërinë tonë. Pjesëmarrësit e moshës mesatare 17-vjeçë edhe njëherë tjetër dëshmuar vullnetin dhe aftësinë e tyre, për të participuar dhe për të jetuar qytetarinë – nga rruga e deri në pallatin federal.

Valis: Kritika e Unia ndaj Zyrës së Migracionit

Shkeljet janë bërë përditshmëri

Shkeljet kundër Marrëveshjes për lëvizje të lirë të personave (FZA/ ALCP), ligjit të huajve dhe për integrim (AIG/ LEI) dhe mosrespektimi i vendimeve juridike udhërrëfyese janë bërë përditshmëri tek zyra e migracionit të Valisit. Kjo ka pasoja të rënda për punëmarrësit e huaj dhe ndërmarrjet në Kantonin e Valisit. Unia identifikon problemet që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit dhe kërkon praktika të reja.

Marília Mendes

Enti i migracionit bëri bujë, kur mbylli zyrat në shtator 2022, për të «përpunuar malin e rasteve në pritje». Unia ka përshëndetur këtë hap, mirëpo kërkoi edhe ndryshimin e praktikave. Me 30 janar 2023, Unia a Valisit bëri një bilanc, i cili doli shkatërrues. Ai tregoi se problemet edhe më tej janë serioze.

Maltretim i panevojshëm i njerëzve

Kështu Unia lejoi që dosjet të shikoheshin në mënyrë anonime dhe tregoi se zyra e migracionit ka bërë rregullisht shkelje të FZA/ALCP dhe AIG/LEI, si dhe nuk ka respektuar vendimet udhërrëfyese juridike. Të prekurit përjetojnë një refuzim sistematik të vendimeve juridike, sikur edhe pengesat e panevojshme me rastin e bashkimit familjar, apo kur qytetarët e BE duhet të sigurojnë e tregonin dokumentet, të cilat bazuar në FAZ/ALCP nuk duhet kërkuar fare. Për të prekurit kjo domethënë, jo vetëm pasiguri e stres të ndërlydhura me problemet e përditshmërisë, por edhe shkaktojnë shpenzime të mëdha financiare.

Vlerësimi juridik doli katastrofë

Ekspteri juridik i migracionit Marc Spescha



Prezantimi i shkeljeve nga eksperti juridik i migracionit me porosi të Unia

identifikoi tek zyra e migracionit «mangësi serioze», të cilat për të prekurit kanë pasoja të padurueshme juridike dhe që kjo praktik paraqet «shpërdorim të parave të tatimeve».

Për sindikatën Unia nuk është e pranueshme, që një zyre e autoriteteve shkel në

mënyrë masive marrëveshjet ndërkombëtare dhe ligjet nacionale. Zyra e migracionit duhet menjëherë ti korrigjoi shkeljet, për të përmbushë detyrën publike dhe që më në fund të prekurve në Kanton tu shërbejë me drejtësi.

Intervista



Foto©Manu Friederich

Aksioni katër të katërtat nis iniciativën demokratike

Me 22 janar 2023 aksioni «Vierviertel» (katër të katërtat) ka paraqitur tekstin e iniciativës popullore për të drejta moderne civile. Në te aleanca e gjerë e shoqërisë civile kërko të drejtën për natyralizim për të gjithë, të cilët ka 5 vite që jetojnë në Zvicër dhe që përmbushin kushtet objektive. Iniciativa demokratike duhet të ndryshoi praktikën përkitazi me të drejtat civile zvicerane. Marie Saulnier Bloch është nënkryetare e shoqatës dhe e prezanton iniciativën.

Marie, çka është aksioni katër të katërtat?

Pas shoqatës aksioni katër të katërtat qëndrojnë njerëz nga shoqëria civile, të cilët angazhohen profesionalisht dhe privatisht rreth temave migracioni, demokracia, politika, shoqëri e drejtë dhe pjesëmarrje e barabartë në Zvicër. Shoqata ka një bazë të gjerë politike dhe profesionale.

Përse starton aksioni katër të katërtat një iniciativë?

Një çerek e njerëzve në Zvicër nuk kanë të drejta politike, pasi që nuk kanë pasaportë zvicerane. Procedurat e marrjes së shtetësisë shumë shpesh janë arbitrare dhe shqetësuese. Me kufizimet në ligjin për të huajt, ka gjithashtu një pasiguri në rritje sa i përket të drejtave të qëndrimit. Aktualisht vetëm pasaporta zvicerane mundëson të drejtat politike në nivel federal dhe gjithashtu mbron nga dëbimi dhe garanton lirinë dhe sigurinë e qëndrimit. Iniciativa paraqet gjithashtu një moment historik: pasi që e vetmja nismë popullore progresive për më shumë të drejta daton më shumë se 50 vjet prapa. Në parlament janë refuzuar të gjitha kërkesat përparimtare. Ne kemi pritur tepër gjatë. Ne duam të pushtojmë këtë fushën dhe nuk do të lejojmë që e djathta politike të reduktojë më tej të drejtat dhe njëherazi e përjashton në demokraci një çerekun e popullatës, e cila kontribuon në të arriturat e Zvicrës. Ne kërkojmë zëshëm që të zhvillohet një debat i hapur dhe transparent publik mbi të drejtat politike.

A mund të na tregosh shkurt, çka përmban iniciativa

Ligji i natyralizimit i rishikuar parasheh, që personat për të marrë shtetësinë duhet të kenë lejen e përhershme të qëndrimit C, që jetojnë së paku për 10 vite dhe që janë të integruar në Zvicër. Fëmijët dhe të rinjtë pas 6 vitesh. Tek vlerësimi i kriterëve të integritimit, kantonet dhe komunat janë të lira dhe kjo shpesh qon në refuzime arbitrare. Ne propozojmë që në të ardhmen: pas 5 vitesh qëndrim legal në Zvicër duhet të jetë e mundur të aplikohet për shtetësi, dhe atë pa marrë parasysh statusin e qëndrimit. Për këtë nevojiten kriterë objektive dhe të kuptueshme, të tilla si: mos të kenë qenë në burgim afatgjatë, të mos paraqesin asnjë kërcënim për sigurinë e brendshme dhe të jashtme dhe të posedojnë aftësi themelore gjuhësore. Kështu do të pengohet, që kantonet dhe komunat mos të refuzojnë në mënyrë arbitrare aplikimet e njerëzve që punojnë në Zvicër, apo edhe kanë lindur këtu, duke shtuar kriterë të tjera arbitrare vetëm për të përjashtuar njerëzit nga pjesëmarrja në demokraci, sikur të ishte shtetësia zvicerane një klub privat i të privilegjuarve.

Nëse anëtarët tanë të Unia duan të angazhohen. Si mund ta bëjnë këtë?

Përkrahni iniciativën, duke mbledhur nënshkrime bashkë kolegët tuaj në grupin e interesit të migracionit, por edhe në shoqatat, në të cilat ju jeni aktiv. Natyrisht anëtarësohuni edhe në shoqatën tonë! Nëse mundeni, themeloni apo bashkohuni një komiteti lokal në komunën apo regjionin tuaj dhe dhroni për iniciativën tonë popullore. Në fund: tregojuni shoqërisë, rrethi dhe të njohurve tuaj për iniciativën. Së bashku jemi më të fortë!

Hilmi Gashi

Më shumë informacione: www.aktionvierviertel.ch

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Invaliditeti: ç' duhet bërë, nëse nuk mjafton pensioni i invaliditetit?

Pas një aksidenti të rëndë vëllai im një pension të plotë invaliditeti. Në të vërtetë ky pension nuk mjafton për të mbuluar të gjitha harxhimet jetësore. Prandaj ai ka bërë një



kërkesë për të shtesën suplementare. Mirëpo, arka kompensuese ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se vëllai im ka shumë pasuri. Kjo është plotësisht absurde, pasi ai bën një jetë modeste. Arka kompensuese argumenton me kursimet e kapitalit të pleqërisë së vëllait tim, edhe pse ato kursime janë të bllokuara në një konto. A është ky vendim korrekt?

Marina Wyss: Po, përderisa vëllai juaj është i vetëm dhe nëse shumica e përfitimeve të tija kalojnë shumë mbi 100 000 franga. Për çiftet e martuara pragu i pasurisë është 200 000 franga. Ky rregullim është në fuqi nga 1 janari 2021. Qysh para kësaj, Gjykata e Lartë Federale njohu përfitimet e kapitalit të kursyera si të ashtuquajtur aset konsumues, edhe nëse në të vërtetë këto kursime nuk janë tërhequr fare. Sipas Gjykatës federale mjafton, që tërheqja e këtyre kursimeve lejohet ligjërisht dhe në parim është e mundur. Pasi vëllai juaj merr një pension invaliditeti të plotë, ai sipas ligjit kam mundësi të kërkoj ti paguhen kursimet e përfitimeve të veta. Dhe atë që nga koha kur aprovimi i pensionit të plotë të invaliditetit është i plotfuqishëm. Të drejtë në shtesa suplementare vëllai juaj ka, nëse kursimet janë nën 100 000 franga.

(Work, 16.12.22)

Koha e punës: A duhet shefi të paguaj për punën paraprake a atë pasuese?

Unë punoj në një dyqan të vogël të lagjes si ndihmës shitëse. Shitorja është gjithmonë hapur nga ora 8 deri 12 deh nga ora 14 deri në 18. Për të mundur që me kohë të shërbejë arkën nga mëngjesi, mua më duhet së paku 10 minuta më herët të jem në vend të punës. Në mbremje kur ne e mbyllim shitoren, për të përmblyllur llogaritë mua më duhet së paku 15 minuta. Shefi im megjithatë nuk donë të ma paguajë këtë kohë. A kam të drejtë që megjithatë të kërkoj këtë?

David Aeby: Po. Koha gjatë së cilës ju si e punësuar duhet të jesh në dispozicion të punëdhënësit tuaj, sipas ligjit të punës vlen (Udhëzimi 1, Neni 13) si kohë pune. Në rastin tuaj nuk ka mëdyshje që puna e juaj përgatitore dhe ajo pasuese në ndërlidhje me arkën është kohë që nevojitet për ta kryer punën. Vështirë se do të jetë në interesin e shefit tuaj që ju ta filloni punën fiks në orën 8 të mëngjesit, pasi kështu do të largoni klientët. Andaj ju rekomandoj të kërkonj një bisedë me punëdhënësin tuaj dhe t'ia bëni me dije, që ai ligjërisht është i obliguar tua shpërblejë gjithë kohën e punës. Nëse shefi i juaj edhe më tej refuzon, atëherë lajmërohuni tek Unia e regjionit tuaj.

(Work, 20.1.23)

Afati i dorëheqjes: A zgjatet në rast sëmundjeje?

Unë para një muaji kam dhënë dorëheqje nga vendi im i punës dhe marrëdhënia e punës duhet të përfundonte me 30 nëntor, pasi unë kisha për të filluar punën e re me 1 janar. Sipas kontratës unë kam një afat dorëheqjeje prej 1 muaji. Vendi i punës është Berna. Unë kam punuar më se tri vite për këtë ndërmarrje. Në kontratën e punës nuk qëndron asgjë për vijimin e pagës në rast sëmundjeje dhe unë nuk i nënshtrohem ndonjë Kontrate Kolektive të Punës. Që nga 11 nëntori jam sëmurë dhe sipas mjekut nuk mund të punoj për 4 javë. Një sigurim të mëditjeve në rast sëmundjeje ne mjerisht nuk e kemi. Unë kam dëgjuar se sëmundja qon në zgjatje të afatit tim të dorëheqjes. A qëndron kjo dhe deri kur do të merrja pagën?

Regula Dick: Mjerisht sëmundja në rast të afatit të dorëheqjes qon vetëm atëherë në zgjatje, nëse punëdhënësi ju ka dhënë dorëheqjen. Pasi që ju vet keni dhënë dorëheqjen, marrëdhënia e juaj e punës përfundon me 30 nëntor. Gjatë sëmundjes ju keni të drejtë në vijimin e marrjes së pagës përgjatë dy muajve. Bazuar në Nenin 324 të së Drejtës Obliguese ju në rast sëmundjeje keni të drejtë në vazhdim të marrjes së pagës. Pasi vendi i juaj i punës ishte Berna, atëherë zbatohet shkalla e Bernës. Kjo në parim në vitin e katërt të shërbimit ofron të drejtën e vazhimit të pagës përgjatë dy muajve. Ky vazhdim i pagës megjithatë të përfundon paraprakisht shkaku i dorëheqjes suaj dhe përfundimit të marrëdhënies së punës me 30 nëntor.

(Work, 18.11.22)

Ekspozita në Biel: «Ne, sezonierët...»

Na trego historinë tënde!

Përmes statusit jonjerëzor Zvicra shfrytëzonte me dekada migrantet e migrantët. Muzeu i ri në Biel dëshiron të inkurajojë të prekurit, që të flasin për fatin e tyre jetësor.

Ralph Hug, *workzeitung*, 16 dhjetor 2022 (e përshtatur Marilia Mendes)

Për gati 70 vjet ata duhej të përbiroheshin: sezonierët nga Italia, Spanja, Portugalia e vendeve të ish-Jugosllavisë. Me qindra mijëra punonin në industri, ndërtimtari dhe bujqësi. Fëmijët e tyre u duhej ti lenin pas veti apo ti fshihnin. Sot, 20 vite pas përfundimit të statusit të sezonierëve, janë duke pritur edhe më tej një kërkim falje zyrtare. Mungon edhe një përpunim publik i kësaj historie. Këtë tani donë ta ndryshojë muzeu i ri në Biel. Përgjegjësi artistik Florian Eitel thotë: «Ne i vendosim punëtorët sezonalë në qendër të ekspozitës sonë».

Traumata jetësore

Statusi famëkeq i sezonierëve ishte në fuqi për 68 vjet, gjegjësisht nga viti 1934 deri më 2002. U ndërta Zvicra e barakave me kushtet e rënda banimi, shfrytëzimi i punëtorëve të ri burra e gra, nën vëzhgim të policisë për të huaj dhe diskriminimit shoqëror përmes

popullatës ksenofobe deri edhe raciste zvicerane. Në ndërkohë sh-trirja çnjerëzore po bëhet e qarte: rreth 50 000 fëmijë sezonierësh u rritën në fshehtësi, pasi prezenca e tyre sipas statusit ishte ilegal. Frika, për tu zbuluar e dëbuar, për shumë nga ta është shndërruar në traumë jetësore.

«Ajo çka neve ende na mungon, janë historitë konkrete jetësore», thotë Eitel. «Andaj ne duam të inkurajojmë të prekurit, që të tregojnë historitë e tyre personale.» Për këtë arsye, në ekspozitë është vendosur edhe një kabinë telefonimi nga viti 1973, ku të interesuarit mund të tregojnë historitë e tyre. Diçka kemi arritur të mbledhim, tregon Eitel. Mirëpo gjithashtu kemi vërejtur, se shumë nga të prekurit e kanë të vështirë të përballen me këtë të kaluar e cila për ta është ngarkuese.

Ekspozita në Biel zgjat deri në qershor 2023. Programi shoqëruar përbëhet nga shpjegimet hyrëse, prezantimet me regjistrime zanore, lexime, biseda dhe me seri filmash. Më 11 mars nga ora 13:30 do të zhvillohet një diskutim me dëshmitarë të kohës që do të organizohet nga Unia. Më shumë për këtë nmbiel.ch.

Fëmijët e fshehur nëpër dollapë

Deri në mars 2023 në muzeun historik të La Chaux-de-Fonds mund të vizitohet ekspozita e parë mbi fëmijët e fshehur në dollapë. Informacionet: mhcdf.ch



Gerva e punëtorëve sezonierë në Biel (viti 1974)

Seminari për anëtarë aktiv në gjuhën shqipe Më 11 e 12 mars 2023 në «Flora Alpina» të Vitznau-t

Të nderuara aktiviste e aktivistë të sindikatës Unia, ju njoftojmë se me 11 dhe 12 mars 2023, e shtunë dhe e diel, do të mbahet seminari në gjuhën shqipe.

Temat kryesore që do të trajtohen të seminar do të jenë:

- Nisma e demokratike «Aktion Vierviertel». Përmbajtja e nismës, qëllimet dhe mundësitë për pjesëmarrje. Mbi të gjitha do të diskutohet për rolin e aktivisteve në fushatë.
- Greva e grave në profesionet e ndërmarrjet ku ato punojnë dhe roli i aktivisteve në mobilizim.
- Roli i aktivisteve në rekrutimin e anëtarëve nuk do të diskutohet vetëm në aspektin e përmbajtjes, por do të bëhen edhe ushtrime praktike.



Seminari organizohet dhe udhëhiqet nga Hilmi Gashi.

Të gjithë anëtarët aktiv që duan te marrin pjesë, luten që sa më shpejt ta konfirmojnë pjesëmarrjen përmes Unia të regjionit të tyre, apo edhe drejtpërdrejtë tek Hilmi Gashi, hilmi.gashi@unia.ch